



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.ledinica Org.Unit	57-02
Nr. i Fajteve Bc. Stranica No. Pages	-09-
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	2743-2/23
Data Datum Date	11.06.24
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	02.05.2024
REFERENC-Ë:	23/2743/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"FRUTEX" Sh.p.k- Suharekë Fabrike për prodhimin e keqapit
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit, "FRUTEX" Sh.p.k- Suharekë, me Nr. Prot. 23/2743/MMPHI dhe ka vendosur si ne Vendim për Leje Mjedisore të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/2743/MMPHI

Datë: 02.05.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatori "FRUTEX" Sh.p.k- Suharekë, Fabrike për prodhimin e keqapit, **pajiset me Leje Mjedisore**, në ngastrën nr.02785-19 dhe nr. 02785-18, zona kadastrale Suharekë.
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Vlerat e cilësisë së ajrit të jenë në nivelin e lejuar sipas legjislacionit në fuqi;
 - 2.3. Raportin e emisioneve ne ajër sipas dinamikës së përcaktuar me legjislacion të i dorëzohet MMPHI-së;

- 2.4. Te respektohen kushtet e përcaktuara me Lejet Ujore për shfrytëzim dhe shkarkim të ujit;
- 2.5. Te avancohet impianti i trajtimit të ujërave që shkarkohen nga procesi i prodhimit teknologjik sipas praktikave me të mira të mundshme sipas legjislacionit në fuqi;
- 2.6. Të avancohet sistemi për depluhurimin e gazrave shkarkuese;
- 2.7. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI-në;
- 2.8. Për sistemin menaxhues mjedisor të këtë personin e profilit mjedisor që është përgjegjës për mjedis;
- 2.9. Për zgjerim të kapacitetit dhe ndryshim të veprimtarisë, operatori obligohet të njoftoj MMPHI-në;
- 2.10. Afati i lejes Mjedisore është për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga dita e lëshimit të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Është shqyrtuar kërkesa për Leje Mjedisore për operatorin, "FRUTEX" Sh.p.k- Suharekë Fabrike për prodhimin e keqapit, në ngastrën nr. 02785-19 dhe nr.02785-18, zona kadastrale Suharekë.

Operatori ka bashkangjitur dokumentacionin:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr.21/5212/1-ZSP/21 Datë: 22.12.2021
- Aktvendimin e Komunës Suharekës, me 07/nr.156/350-18055, të datës:10.06.2020
- Leje Ujore- për Shfrytëzim të ujit me nr.1992/23-ZSP-2023 të lëshuar me dt. 27.11.2023;
- Pëlqim Ujor- për Shkarkim të ujit me Nr. 1991/23-ZSP-2023, të lëshuar me dt. 27.11.2023;

Andaj bazuar ne dokumentacionin e dorëzuar dhe plotësuar nga pala dhe gjendjes faktike, duke përfshi shikimin ne vend nga zyrtarët profesional sipas legjislacionit ne fuqi për mjedisin, dhe Udhëzimit Administrativ te MMPHI- se Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore janë paraqitur kushtet si ne diapozitiv.

Afati i përcaktuar i lejes mjedisore ne diapozitiv është përcaktuar, në përputhje nenit 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Suharekë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.